



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 4962 / Prot
5

Tiranë, më 6/10 2021

URDHËR

Nr. 655, Datë 6, 10 2021

PËR
LIRIMIN E MENJËHERSHËM PËR SHKAQE TË JUSTIFIKUARA TË ZNJ.
IRIS ELEZI NGA DETYRA E DREJTORIT TË ARKIVIT QENDROR
SHTETËROR TË FILMIT

Në vijim të procedurës administrative të filluar ndaj znj. Iris Elezi, Drejtor i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit bazuar në shkresën nr. 4962 prot, datë 27.09.2021, shkresën nr. 4962/1 prot., datë 29.09.2021 "Njoftim për takim për vijimësinë e marrëdhënies së punës", në shkresën nr. 4962/3, datë 4.10.2021 "Procesverbal", duke vlerësuar faktet dhe provat, shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, si dhe të mosparaqitjes së saj në seancë dëgjimore për arsye jo objektive, të panjoftuara dhe të pamiratuara në organin epror pavarësisht marrjes së njoftimit, është e nevojshme marrja e vendimit administrativ.

Bazuar në procedurën e ndjekur sa më lart citohet, vlerësohet se znj. Elezi gjatë ushtrimit të detyrës së saj ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke mosrespektuar parimin e mirëbesimit, detyrimin e bindjes dhe përgjegjësisë, si dhe detyrimin e punëdhënësit për mbrojtjen e personalitetit të punëmarrësit në referencë të sa vijon:

1. Mosrespektim i përsëritur i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar referuar, sa i takon:
 - 1.1 Konfirmimit nga ana e ILDKPI, të pranisë së gjendjes së konfliktit të interesit lidhur me paraqitjen e projektit për filmin artistik me metrazh të gjatë "Të gjithë vdesin lakuriq", me skenar të Iris Elezi, Tomas Logoreci (bashkëshorti/bashkëjetuesi), regjia Iris Elezi, bazuar në praktikën e iniciuar nga QKK.
2. Gjetjet e Raportit final të auditimit adresuar në AQSHF, të kryer nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Kulturës.
 - 2.1 Ankesës së ngritur nga disa punonjës të AQSHF-së lidhur me praninë fizike në institucion të bashkëshortit dhe jo vetëm, por edhe punësimit të tij prej 1 viti si supervisor në projektin MEAP.
3. Mosrespektim i përsëritur i Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, sa i takon:
 - 3.1 Mosrespektimit të procedurës administrative lidhur me procedimin disiplinor si dhe/apo të akteve të tjera të brendshme, bazuar në:

- shkresën 4566 prot., datë 07.09.2021 “Ankesë mbi Urdhrat e Brendshëm të lëshuar nga drejtoresha e AQSHF-së Iris Elezi” lidhur me dy urdhra të brendshëm të institucionit, konkretisht Urdhri nr. 27, datë 30, datë 3.9.2021, si dhe Urdhri nr. 30, datë 3.9.2021,
 - shkresën 4567, datë 07.09.2021 “Ankesë për titullare e AQSHF-së”.
4. Mosrespektim i përsëritur i Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, bazuar në pretendimet e shkresës nr. 4567 prot., datë 07.09.2021, me lëndë “Ankesë për znj. Iris Elezi, titullare e Arkivit Qendror Shtetëor të Filmit”, lidhur me marrëdhënien, komunikimin dhe sjelljen me punonjësit e institucionit. Pavarësisht faktit që me shkresë nr. 4567/1, datë 17.09.2021.
 5. Gjetjet e Raportit final të auditimit adresuar në AQSHF-në, të kryer nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Kulturës.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punes i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të vendimit nr. 173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”, të Statutit të institucionit, Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Lirimimin e menjëhershëm për shkaqe të justifikuara të znj. Iris Elezi nga detyra e Drejtorit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, institucion në varësi të Ministrit të Kulturës.
2. Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara.
3. Dhënien e shpërblimit për pushimet e pamarrë.
4. Dorëzimin e dokumentacionit, të pajisjeve, mjeteve të punës në inventar dhe dorëzimin e plotë të detyrës brenda datës _____.____.2021.
5. Çdo veprim administrativ i kryer pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri, konsiderohet i pavlefshëm.
6. Dorëzimin e formularit të deklarimit të pasurisë “Pas largimit nga funksioni”, brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni.
7. Ngarkohet Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Elva Margariti

